

*Appeal / Drejtoria  
I +  
St. J.*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
DURRËS**



- P.ÇURI -

Nr. Regj 1288

**SHPALLJE**

**Adresa: Qendra Kombetare e Regjistrimit**

*Tirane*

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës ka përfunduar gjykimi i çështjes civile që i përket:

**PADITËSE:** Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës

**PALE E TRETË :** Shoq"Xhana" sh.p.k

**ME OBJEKT:** Fillim procedure falimenti.

Ku eshte vendosur :

**V E N D O S I :**

Rrëzimin e kërkesës të palës kërkuese, Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, me të palë të tretë "Xhana"shpk,dhe QKR Tiranë, me seli në ,Durrës.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kunder vendimit lejohet ankim brenda 15 diteve ne Gjykatën e Apelit Durrës.Për palët në mungesë afati fillon nga dita e komunikimit të vendimit.

Durres,më 19.07.2011

Kjo shpallje behet per efekt te njoftimit te vendimit dhe ankimit te bere nga Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës per Shoq"Xhana" pasi njoftimi me deftese nuk eshte i mundur.

**KANCELARE  
ARDENA VELI**

*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PERGJITHESHME E TATIMEVE  
Drejtoria Rajonale Tatimore Durres



Lagjia Nr 3 Rruga "Skenderbeg"

Tel:052/22132 /tel/ Faks:052/20450

Nr. 17504 Prot

Durres, më 25.07.2011.

KERKES ANKIMORE

ANKUESI: Drejtoria Rajonale Tatimore Durres  
KUNDER : Vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Durres date 19.07.2011  
Me pale  
Padites: Drejtoria Rajonale Tatimore Durres  
Paditur Xhana shpk  
OBJEKTI : Per fillimin e procedurave te falimentimit  
Baza ligjore: Neni 452 K.P.Civile  
PERPARA : Gjykates se Apelit Durres

I Nderuar trup gjykues

Gjykata e shkalles se pare Durres me vendimin e sajë date 19.07.2011

Vendosi;

Mos pranimin e kerkeses per fillimin e procedures se falimentimit.

Duke e konsideruar vendimin si te pa bazuar ne prova e ne ligj kerkojne rrezimin e ketij vendimi duke dhene arsyet tona si me poshte:

Ne perfundim te shqyretimit gjyqesor u vu re se subjekti ka deklaruar humbje te kapitaleve te veta te pakten per 3 vjet rresht, dhe per kete shkak gjykata duhet te nise procedurat e falimentit kjo ne kuptimin e nenit 104 te ligjit 9920 date 19.05.2009 Per Procedurat Tatimore ne RSH, I cili nuk I le shkak as hapësire gjykates te mos nise kete procedur.

TIRIFE E DARRË  
BARRISHTA

Jemi te mendimit se kjo procedur duhet te nise edhe per shkakun e mbrojtjes se kreditoreve te tjere te interesuar qe kredite e tyre te jene te mbrojtura dhe te mos kete rreziqe qe edhe subjekte te tjere te falimentojne per mos shlyerje te debive qe ky subjekt I ka personave te trete. Duhet te veme re se kreditore te tjere nuk paten kohen e nevojteshme per te marre dijani ne lidhje me kete proces.

Shoqeria kapitalin fillestar e ka te deklaruar 100.000 leke, ndersa humbjet e kryra per vitet 2006,2007,2008 i ka disa qindra mijera leke te reja mbi kete kapital.

Subjekti eshte debitor ndaj D.R.T.Durres sipas proves se dorrezuar ne gjykate dhe ndoshta edhe ndaj te treteve gje qe nuk u evidentua ne kete hetim gjyqesor Ne perfundim I kerkojme gjykates nisjen e procedurave te falimentit per subjektin Xhana shpk dhe rrezimin e Vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Durres

DREJTOR

SHKELQIM FORTUZI

